



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

V E N D I M

Nr. _____, datë _____ 2016

**PËR KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË LABORATORI I
REFERENCËS DHE LABORATORËT E AKREDITUR DHE
ANALIZAT QË KRYEJNË KËTA LABORATORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 44 të ligjit nr. 10416 datë 7/4/2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” me propozimin e Ministrit të Bujqësisë Zhvillimit Rural, dhe Administrimit të Ujërave”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret që duhet të plotësojë laboratorit i referencës dhe laboratorët e akredituar për tu miratuar si dhe analizat që kryejnë këta laboratorë.
2. Të gjitha termat e përcaktuara në ligjin nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtin kuptim dhe në këtë vendim.

**II. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË LABORATORI I REFERENCËS DHE
LABORATORËT E AKREDITUAR`**

1. Laboratori i referencës shërben si laborator për vlerësimin e cilësisë dhe besueshmërinë e analizave të kryera nga laboratorët e miratuar, si dhe jep vlerësimin përfundimtar të testeve të kryera në këto laboratorë.

1.1 Për tu miratuar laboratori i referencës duhet të plotësoj këto kritere:

- a) të ketë të paktën 10 vjet aktivitet në kryerjen e analizave për përcaktimin e treguesve cilësorë të farave të bimëve bujqësore;
- b) të jetë i akredituar sipas standardit ISO, për analiza apo grup analizash të veçanta;
- c) të kryejë analiza të mostrave të farave të bimëve bujqësore për efekt të verifikimi të treguesve cilësor të materialit mbjellës shumëzues bimor që vendoset në treg;
- d) të ketë rregulloren për funksionimin e laboratorit të miratuar nga ministri;
- e) të mbajë regjistrin e laboratorit, për rezultatet e analizave të mostrave të farave të bimëve bujqësore;
- f) të kryejë analizat laboratorike, bazuar në metodikën dhe rregulloren e ISTA;
- g) fletë analiza me rezultatet përfundimtare të plotësohet mbi bazën e testit të kryer nga specialisti përgjegjës për kryerjen e testit, konfirmohet nga përgjegjësi i laboratorit, dhe pasi vulozet me vulën e laboratorit i jepet subjektit aplikues dhe një kopje ruhet në laborator;
- h) të ketë përkrahje të vendit të punës për çdo punonjës të stafit, të cilët duhet të kenë kualifikim teknik të nevojshëm për kryerjen e analizave, sipas standardeve dhe rregullores së ISTA;
- i) të ketë një person përgjegjës për menaxhimin teknik të laboratorit, të diplomuar ing. kimist, që ka përvojën dhe kualifikimin e nevojshëm për të drejtuar një laborator për kryerjen e analizave të farave të bimëve bujqësore, si dhe për operacionet teknike të këtij laborator;
- j) të ketë ambiente të nevojshme, pajisje të përshtatshme laboratorike, dritë dhe hapësirë të mjaftueshme për të siguruar saktësi për kryerjen e analizave në përshtatje me kërkesat e standardit ISO-9001;
- k) mjediset e laboratorit duhet të jenë të mbrojtura nga ndikimi i kushteve të tilla si temperaturë shumë e lartë, pluhuri, lagështia, avulli, vibracionet, fusha elektromagnetike, interferenca si dhe të ketë burim energjie rezervë;

1.2 Vlerësimi i kriterëve të sipërcituara për laboratorin e referencës për tu miratuar bëhet nga grupi i punës i ngritur me urdhër ministri.

1.3 Forma dhe përmbajtja e regjistrit të laboratorit është përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Laboratori i akredituar, për tu miratuar, duhet të plotësojë këto kritere:

- a) të ketë të paktën 2 vjet aktivitet në kryerjen e analizave për përcaktimin e treguesve cilësorë të farave të bimëve bujqësore;
- b) të ketë ambiente të nevojshme, pajisje të përshtatshme laboratorike, për të siguruar saktësi për kryerjen e analizave;
- c) të jetë i akredituar sipas standardit ISO, për analiza apo grup analizash të veçanta;
- d) të kryejë analiza të mostrave të farave të bimëve bujqësore për efekt të verifikimit të treguesve cilësor të materialit mbjellës shumëzues bimor që vendoset në treg;
- e) të ketë rregulloren për funksionimin e laboratorit të miratuar nga titullari;
- f) të mbajë regjistrin e laboratorit, për rezultatet e analizave;
- g) fletë analiza me rezultatet përfundimtare të plotësohet mbi bazën e testit të kryer.

2.1 Vlerësimi i kritereve të sipërcituara për laboratorin e akredituar, për tu miratuar bëhet nga grupi i punës i ngritur me urdhër ministri.

2.2 Forma dhe përmbajtja e regjistrit të laboratorit është përcaktuar në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. ANALIZAT QË KRYEJNË LABORATORI I REFERENCËS DHE LABORATORI I AKREDITUAR

1. Laboratori i referencës kryen të gjitha llojet e analizave për të gjithë llojet e farave të specieve të bimëve bujqësore si më poshtë:

- a) analiza për certifikimin zyrtar;
- b) analiza zyrtare për të gjitha kategoritë e farave të importuara ose prodhuara në vendit tonë;
- c) analiza për testimin e varieteteve të reja për regjistrimin e tyre në Katalogun Kombëtar (KK);
- d) analiza për qëllime shkencore dhe studimore (testi i tetrazoliumit dhe testi i plakjes së farës col test);
- e) analiza për efekt monitorimi për cilësinë e kryerjes së analizave nga laboratorë

të tjerë zyrtarë të miratuar;

- f) rianalizimi i materialit mbjellës e shumëzues bimorë për treguesit e fuqisë mbirëse;

1.1 Kur subjekti aplikues ka pretendime ndaj rezultatit të analizave, brenda 5 (pesë) ditëve organizohet ballafaqim me përfaqësuesit e laboratorit. Rivlerësimi i rezultateve të analizës bëhet mbi bazën e analizës së një mostre të re, që merret nga një komision i cili ngrihet me urdhër të titullarit të institucionit.

1.2 Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit të nevojshëm për analizat që kryen laboratorit i referencës është përcaktuar në shtojcën 3 dhe 5 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Laboratori i akredituar për tu miratuar kryen këto analiza:

- a) analiza për të gjitha kategoritë e farave të importuara ose prodhuara në vendin tonë;
- b) rianalizimi i materialit mbjellës e shumëzues bimorë për treguesit e fuqisë mbirëse;
- c) analiza për treguesit cilësorë të materialit mbjellës e shumëzues bimor për:
 - i. fuqinë dhe energjinë mbirëse;
 - ii. përmbajtjen e lagështirës;
 - iii. pastërtinë varietore;
 - iv. përzierjen mekanike;

2.1 Forma dhe përmbajtja e regjistrimit të laboratorit është përcaktuar në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit të nevojshëm për analizat që kryen ky laboratorë është përcaktuar në shtojcën 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi RAMA

Shtojca 3

Llojet e analizave (Laboratori i Referencës)

Analiza nr

Kultura
Varieteti
Kodi i mostrës.....
Pesha e kontingjentit

Viti i prodhimit
Riprodhimi.....
Marrë nga inspektori.....

A. Përcaktimi i përmbajtjes së lagështirës

Nr i provës	Pesha e enës me kapak gr.	Pesha e farës gr.	Pesha e enës (me farën dhe kapakun)		Humbja në peshë nga tharja		% e lagështirës
			Para tharjes në gr	Pas tharjes në gr	Në gr.	Në %	
I							
II							

B. Përcaktimi i Pastërtisë

Komponentët	Prova e parë		Prova e dytë		Mesatarja në %
	Në gr	Në %	Në gr	Në %	
Farë e pastër					
Fara të tjera					
Lëndë inerte					
Totali					

C. Përzjerja mekanike

Emërtimi	Numri i copëve				
	Në provën e I-rë	Në provën e II-të	Në mbetjen e mostrës	Gjithsej në mostër	Në 1 kg farë
Fara të tjera					
Barëra të këqija					
Barëra të karantinës					

D. Testi i mbirjes

Temperatura
Substrati i mbjelljes
Nr i farave të testuara
Kodi i testit
Nr. ditëve të testimit

Në drite
Në errësira
Specia
Varieteti

Vlerësimi %	Përsëritjet e mostrave				Mesatarja %
	I	II	III	IV	
Numërimi i pare					
Numërimi i dyte					
Normalet					
Fara te forta					
Fara te buta					
Anormale					
Të vdekura					

_____ më datë ___/___/_____

ANALISTI

Shtojca 4

Llojet e analizave (Laboratori i akredituar i miratuar)

Analiza nr

Kultura
Varieteti
Pesha e kontigjentit

Viti i prodhimit
Riprodhimi.....

A. Përcaktimi i përmbajtjes së lagështirës

Nr i provës	Pesha e enës me kapak gr.	Pesha e farës gr.	Pesha e enës (me farën dhe kapakun)		Humbja në peshë nga tharja		% e lagështirës
			Para tharjes në gr	Pas tharjes në gr	Në gr.	Në %	
I							
II							

B. Përcaktimi i Pastërtisë

Komponentët	Prova e parë		Prova e dytë		Mesatarja në %
	Në gr	Në %	Në gr	Në %	
Farë e pastër					
Fara të tjera					
Lëndë inerte					
Totali					

C. Përzierja mekanike

Emërtimi	Numri i copëve				
	Në provën e I-rë	Në provën e II-të	Në mbetjen e mostrës	Gjithsej në mostër	Në 1 kg farë
Fara të tjera					
Barëra të këqija					
Barëra të karantinës					

D. Testi i mbirjes

Temperatura
Substrati i mbjelljes
Nr i farave të testuara
Kodi i testit
Nr. ditëve të testimit

Në drite
Në errësira
Specia
Varieteti

Vlerësimi %	Përsëritjet e mostrave				Mesatarja %
	I	II	III	IV	
Numërimi i pare					
Numërimi i dyte					
Normalet					
Fara te forta					
Fara te buta					
Anormale					
Të vdekura					

_____ më datë ___ / ___ / _____

ANALISTI

